

## PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”

**Numri i referencës së procedurës :** REF 86642-11-07-2023

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Klor

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5 600 000(pesemilion e gjashteqindmije) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

###### **1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

###### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2,c), tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

---

**2.2.2** Kopje te certifikuara te bilanceve per 3 vitet e fundit (**2020, 2021 dhe 2022**) te konfirmuara nga autoritetet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçence nga QKL (Qendra Kombetare e Licensimit), per objektin e aktivitetit, sipas objektit te prokurimit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,pika 1,a) dhe c), të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më shume se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar

duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**22.3.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesi fletën e analizës për treguesit si më poshtë : *Pamja (ngjyra dhe era), Klori aktiv Cl2, Kadmium (Cd), Krom (Cr), Nikel (Ni), Plumb (Pb) Densiteti, Arseniku (As), Mërkuri (Hg), Antimoni (Sb), Seleni (Se)*

per produktet që prokurohen (te 3 muajve te fundit), nga nje institucion shteteror si Instituti i Shendetit Publik ose nje institucion tjetër i akredituar ne vend ose jashte vendit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ne te cilin thuhet se;

*“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

**2.3.4** Operatori Ekonomik ose furnitori i tij duhet të garantojë sasinë e produkteve të prokuruar në këtë procedurë, nepermjet ; (a) nëse është prodhuar me një deklaratë të tij (b) nëse është tregues duhet të disponojë një kontratë me prodhuesin(t) për sasinë e prokuruar të barabartë ose me të lartë nga ajo e kërkuar në këtë procedurë.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ne te cilin thuhet se;

*“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

**2.3.5** Operatori Ekonomik, për automjetin transportues, duhet të paraqesë **Certifikatë për Transport Mallrash të Rrezikshme**, të lëshuar nga DPSHTRR, kur automjeti është në pronësi të tij, dhe kur automjeti është marrë me qira, përveç certifikatës së mësipërme, duhet të paraqesë, **Kontratë Qiraje** (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në përfundim të kontratës.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ne te cilin thuhet se;

*“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

dhe ne

Ligjin 118/2012, neni 12, “Për Transportin e Mallrave të Rrezikshme” dhe në Udhezimin nr Nr.15 datë 24.7.2007, I ndryshuar, neni 6, “Për Kriteret dhe Procedurat e Lëshimit të Licensave, Autorizimeve dhe Certifikatave, për Ushtrimin e Veprimtarisë në Transportin Rrugor”

## 1. Specifikimet teknike te kimikateve per trajtimin e ujit

Proçesi teknologjik i trajtimit të ujit realizohet me përdorimin e Hipokloritit të Natriumit 13 – 15 % i cili shërben si oksidues dhe disinfektues.

## 2. Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve

Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkurrese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë

| Nr | Indekset analitike                                | Njësia e matjes | Specifikimet                     |
|----|---|-----------------|----------------------------------|
| 1  | Gjendja   |                 | Lëng                             |
| 2  | Ngjyra  |                 | Ngjyrë e verdhë                  |
| 3  | Densiteti ne 20 <sup>0</sup> C                    | gr/ml           | 1,13 ÷ 1,28                      |
| 4  | Titulli Cl <sub>2</sub>                           | % m/m           | 13-15                            |
|    | <i>Elementet toksikologjike (metalet e renda)</i> | mg/kg           | Limitet ne mg/kg te klorit aktiv |
| 5  | Arseniku (As) max                                 | mg/kg           | 1                                |
| 6  | Cadmium (Cd) max                                  | mg/kg           | 2,5                              |
| 7  | Kromi (Cr) max                                    | mg/kg           | 2,5                              |
| 8  | Merkuri (Hg) max                                  | mg/kg           | 3,5                              |
| 9  | Nikeli (Ni) max                                   | mg/kg           | 2,5                              |
| 10 | Plumbi (Pb) max                                   | mg/kg           | 15                               |
| 11 | Antimoni (Sb) max                                 | mg/kg           | 20                               |
| 12 | Seleni (Se) max                                   | mg/kg           | 20                               |

Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013

### **3.Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve**

Furnizimi me kimikate do të kryhet me mjete tip bot të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e destinuar për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme o të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit janë : 1 vit nga lidhja e kontrates

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

Per Njesine e Prokurimit

**Anila Vjeri            Juriste**

**Viktor Tola            Inxhinier**

**Evelina Takaj           Kimiste**